



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

TETOR 2023

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Tetor 2023

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023
Drejtoria e Përgjithshme e Programimit Makroekonomik
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: Dajana.Metolli@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE _____ **2**

ZHVILLIMET EKONOMIKE _____ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit _____ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit _____ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave _____ 5
4. Bilanci i Pagesave _____ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar _____ 7
6. Kredia për Ekonominë _____ 8
7. Oferta e Parasë _____ 9
8. Depozitat sipas burimeve _____ 10

SEKTORI FISKAL _____ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar _____ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve _____ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal _____ 13

ANEKSI STATISTIKOR _____ **13**


Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Tetor 2023, arriti në 115.45;
- Norma vjetore e inflacionit për muajin Tetor 2023 ishte 3.8 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Tetor 2023 ishte 100.12 lekë për dollarë dhe 105.77 lekë për euro;
- Normat mesatare të interesit të depozitave në lekë sipas individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit Tetor 2023 shënuan kuotën 1.74 dhe 2.49 përqind;
- Normat mesatare të interesit të huave në lekë sipas Individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit Tetor 2023 shënuan përkatësisht vlerat 6.62 dhe 6.29 përqind;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,673,184 milionë lekë në muajin Tetor 2023, duke shënuar një rritje prej rreth 1.0 përqind krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të 2023 rezultoi me rritjen e mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 160.10 milionë euro;
- Situata Buxhetore për periudhën Tetor 2023 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej rreth 47.88 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një sufiçit prej 33.74 miliardë lekë;
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Tetor 2023, arritën në rreth 530.83 miliardë lekë ose afërsisht 0.4% më pak se të ardhurat e planifikuara për këtë periudhë;
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 482.95 miliardë lekë ose rreth 3.2% më pak se shpenzimet të planifikuara për këtë periudhë;

Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Tetor 2023 ishte 3.8%, një vit më parë ky ndryshim ishte 8.3%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Tetor 2023, krahasuar me Shtator 2023 është 0.1%. Një muaj më parë, Shtator 2023, IÇK shënoi një rritje mujore prej 0.7%. Referuar një viti më parë Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Tetor 2022 shënoi rritje mujore prej 0.4%, në krahasim me muajin paraardhës.



Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- “Ushqime dhe pije joalkolike” me rritje vjetore të çmimit prej +7.4%, duke kontribuar me +2.64 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.8%.
- “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje”, me rritje vjetore +5.2%, duke kontribuar me +0.39 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.8%.
- “Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me rritje vjetore të çmimit prej +1.6%, duke

kontribuar me +0.32 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.8%.

- “Hotele, kafene dhe restorante” me rritje vjetore të çmimit prej +4.8%, duke kontribuar me +0.21 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.8%.
- “Argëtim dhe kulturë” me rritje vjetore të çmimit prej +7.6%, duke kontribuar me +0.18 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.8%.
- “Pije alkoolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +3.6%, duke kontribuar me +0.17 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.8%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2022	3.7	3.9	5.7	6.2	6.7	7.4	7.5	8.0	8.1	8.3	7.9	7.4
2023	7.2	7.1	5.3	4.6	4.7	4.5	4.2	4.0	4.1	3.8		


Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Tetor 2023, arriti në 105.77 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 1.00 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Tetor, një euro u këmbye me 105.55 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Tetor 2023 arriti në 100.12 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 0.08 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit Tetor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 99.00 lekë/dollarë.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një nivel mesatar rreth 0.95 dollarë/euro për muajin Tetor 2023.




Në krahasim me muajin Tetor të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 9.79 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 16.05 përqind. Rënia e monedhës euro ka ardhur si pasojë e numrit të lartë të turistëve të huaj dhe të flukseve valutore hyrëse nga turizmi. Forcimi i monedhës vendase ndaj euros këtë vit ka ndihmuar në zbutjen e pjesshme të presioneve inflacioniste nga jashtë.

Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, forcimi i lekut mund të shpjegohet me përmirësimet në bilancin e llogarisë korrente, rritjen e investimeve të huaja direkte, por edhe me efektet e normalizimit monetar dhe rritjes së normave të interesit si dhe si rezultat i stabilitetit të situatës makroekonomike në vend.


3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Tetor 2023, normat mesatare të interesit të depozitave me afat në lekë sipas Individëve dhe Korporatave jo-financiare shënuan përkatësisht vlerat prej 1.74 dhe 2.49 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave sipas individëve kanë shënuar rritje me 0.01 pikë përqindje dhe Korporatave jo-financiare kanë shënuar rënie me 0.01 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë kanë shënuar rritje me 0.45 pikë përqindje për Individët dhe 1.31 pikë përqindje për Korporatave jo-financiare.



Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore për muajin Tetor 2023 kanë shënuar kuotën 3.11 përqind, nga 5.10 përqind që shënonte për të njëjtën periudhë një vit më parë. Bonoja 12-mujore shënoi rënie me 0.04 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë dhe rënie vjetore me 1.99 pikë përqindje.

Gjatë muajit Tetor 2023 normat mesatare të interesit të huave sipas Individëve dhe korporatave jo-financiare shënuan përkatësisht vlerat 6.62 dhe 6.29 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të huave sipas individëve u rritën me 0.11 pikë përqindje ndërsa normat e interesit sipas korporatave jo-financiare u ulën me 0.07 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë kanë shënuar rënie me 1.94 pikë përqindje për Individët dhe kanë rënë me 0.63 pikë përqindje për Korporatave jo-financiare.





4. Bilanci i Pagesave

Në nëntëmujorin e parë të vitit 2023, Bilanci i përgjithshëm i Pagesave rezultoi pozitiv, në rritje të mjeteve të rezervës valutore në vlerën 786 milion euro, nga -58 milion euro që ishte në nëntëmujorin e parë të 2022. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e tretë të 2023, BP shënoi vlerën 160 milion euro, krahasuar me tremujorin e tretë të 2022 që shënoi vlerën 94 milion euro. Për nëntëmujorin e parë të vitit 2023, llogaria korente u zgjerua në 28 milion euro krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë që ishte -590 milion euro. Po ashtu, vetëm për tremujorin e tretë të 2023, llogaria korente u mbyll me balancë pozitive prej rreth 354 milion euro, krahasuar me deficitin e tremujorit të tretë të 2022 që ishte -145 milion euro.


Në nëntëmujorin e parë të vitit 2023, llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në vlerën +720 milion euro krahasuar me +529 milion euro në nëntëmujorin e parë 2022. Ndërsa, vetëm për tremujorin e tretë të 2023, llogaria financiare dhe kapitale shënoi deficitin prej rreth -85 mln euro, krahasuar me suficitin prej rreth +127 mln euro në tremujorin e tretë të 2022.

Në nëntëmujorin e parë të vitit 2023, investimet e huaja direkte u zgjeruan në vlerën +1.088 miliardë euro ose +10.6%, krahasuar me +984 milion euro në nëntëmujorin e parë 2022. Ndërsa vetëm për tremujorin e tretë të 2023, IHD regjistruan vlerën +404 mln euro ose +17.4%, krahasuar me +344 mln euro në tremujorin e tretë të 2022.




5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Tetor 2023, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 47.60 milionë lekë krahasuar me muajin Tetor të vitit 2022. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në Bankat Paradepozituese me 31.74 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me 9.54 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 13.68 milionë lekë e Bankës Qëndrore.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,673,184 milionë lekë në muajin Tetor 2023, duke shënuar një rritje prej rreth 16,552 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 1.0 përqind.

Në muajin Tetor, sistemi bankar rezulton me rënie mujore prej 229.8 milionë lekë.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Tetor 2023 arriti në rreth 730.327 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje në vlerë me 8.001 mijë lekë, ose rritje me rreth 1.11 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (56.0%) dhe monedhave të huaja (44.0%).


Gjatë muajit Tetor 2023, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 56.4 përqind ose 412.087 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 38.6 përqind ose rreth 281.705 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 2.6 dhe 2.4 përqind apo 18.879 dhe 17.538 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Tetor 2023, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 68.6 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 26.2 përqind. “Korporata të tjera financiar” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.3 dhe 3.0 përqind secili.




7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 390.372 milionë lekë në fund të muajit Tetor 2023. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Tetor 2023 ka shënuar një rënie mujore prej 0.14 përqind dhe rritje vjetore prej 0.65 përqind, duke arritur nivelin 23.3 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rënie mujore prej 0.24 përqind, dhe rritje vjetore prej 1.10 përqind, duke shënuar nivelin 30.43 përqind.




Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Tetor 2023, kanë shënuar rënie vjetore prej 661 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 72.4 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Tetor 2023 shënuan rritje prej 2.572 milionë lekë në krahasim me muajin Tetor 2022. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 76.0 përqind të depozitave në lekë.



8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Tetor 2023, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 76.0 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 18.6 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 3.2 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 72.4 përqind dhe rreth 24.9 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 73.9 përqind e totalit.

Fig. 13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 948.073 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (284.785 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (23.287 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (24.109 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (2.558 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit Tetor 2023, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,282.8112 milionë lekë.

Fig. 14



Përberja e depozitave Tetor'23

Burimi: Banka e Shqipërisë


Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 2.343 milionë lekë. Ndërsa, krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 1.911 milionë lekë.

Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Tetor 2023 janë mbledhur rreth 530.831 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 482.947 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 428.132 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 181.112 miliardë lekë në shpenzime për fonde speciale.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 346.781 miliardë lekë (0.1% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 24.625 miliardë lekë. Të ardhurat nga fondet speciale janë rreth 120.667 miliardë lekë (ose rreth 0.8% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 18.146 miliardë lekë (ose rreth 0.5% më pak se plani i periudhës).



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 428.132 miliardë lekë, 81.060 miliardë lekë (18.93% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 40.500 miliardë lekë (9.45% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 48.089 miliardë lekë (11.23% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1.297 miliardë lekë (0.30% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 181.112 miliardë lekë (42.30%) për shpenzime për fonde speciale, 51.894 miliardë lekë (12.12% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 24.182 miliardë lekë (5.73% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime të tjera.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar-Tetor 2023 ishin rreth 530.8miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 492.1miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 18.1miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat tatimore gjatë muajit Tetor 2023 (mln Lekë)

Emërtimi	Tetor'23	Tetor'22	Tet'23/Tet'22 Rritja në (%)
Tatimi mbi Vleren e Shtuar	161,247	161,010	0.1
Tatimi mbi Fitimin	47,875	36,686	30.5
Akcizat	48,092	43,878	9.6
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	48,392	37,716	28.3
Taksa Nacionale dhe të tjera	33,650	38,372	-12.3
Taksa Doganore	7,524	6,950	8.3

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Statistikat Fiskale: Tetor- 2023

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 47.88 miliardë lekë për periudhën Tetor 2023, u mbështet kryesisht nga huamarrja e brendshme si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe huasë afatgjatë të huaj.

Për periudhën Janar-Tetor 2023, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 530.83 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 482.95 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave progresive për periudhën Tetor 2023, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 492.072 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 428.132 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 181.112 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly)					Vjetor (Annual)					Month
	2019	2020	2021	2022	2023	2019	2020	2021	2022	2023	2019	2020	2021	2022	2023	
Janar	1.6	1.9	1.3	1.3	1.1	1.6	1.9	1.3	1.3	1.1	1.9	1.5	0.4	3.7	7.2	January
Shkurt	0.6	0.4	1.1	1.3	1.1	1.1	1.1	1.2	1.3	1.1	1.7	1.2	1.1	3.9	7.1	February
Mars	-0.3	0.6	0.7	2.4	0.7	0.6	0.9	1.0	1.7	1.0	1.1	2.1	1.2	5.7	5.3	March
Prill	-0.2	-0.4	0.2	0.7	0.03	0.4	0.6	0.8	1.4	0.9	1.4	1.9	1.9	6.2	4.6	April
Maj	-1.0	-0.8	-0.9	-0.5	-0.3	0.1	0.3	0.5	1.0	0.7	1.5	2.1	1.8	6.7	4.7	May
Qershor	-0.3	-0.6	-0.8	-0.1	-0.3	0.1	0.2	0.3	0.9	0.6	1.3	1.8	1.6	7.4	4.5	June
Korrik	-0.1	-0.5	0.1	0.2	-0.1	0.0	0.1	0.2	0.8	0.5	1.5	1.4	2.2	7.5	4.2	July
Gusht	0.3	0.2	0.4	0.8	0.6	0.1	0.1	0.3	0.8	0.5	1.5	1.3	2.4	8.0	4.0	August
Shtator	0.1	0.4	0.5	0.6	0.7	0.1	0.1	0.3	0.7	0.4	1.3	1.5	2.5	8.1	4.1	September
Tetor	-0.2	0.2	0.1	0.4	0.1	-0.1	0.1	0.3	0.7	0.4	1.3	2.0	2.4	8.3	3.8	October
Nëntor	-0.2	-0.5	0.2	-0.3		0.0	0.1	0.3	0.6		1.4	1.6	3.1	7.9		November
Dhjetor	-0.2	0.3	0.8	0.4		-0.1	0.1	0.3	0.6		1.4	1.1	3.7	7.4		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2 Kursi i këmbimit
Exchange rate

Monedha					2023	2023	2023	2023	2023	2023	2023	2023	2023	2023	Currency
	2019	2020	2021	2022	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	
Mesatarja e periudhës:															Average of period
USD	109.85	108.65	103.68	113.04	107.90	107.98	106.91	102.45	102.26	99.05	93.38	96.89	100.04	100.12	USD
EURO	123.01	123.77	122.37	118.98	116.39	115.72	114.35	112.38	111.10	107.26	103.24	105.67	106.85	105.77	EURO
Fundi i periudhës															In the end of period
USD	108.64	100.84	106.54	107.05	107.72	108.43	103.96	101.12	102.76	98.15	93.22	99.55	100.48	99.00	USD
EURO	121.77	123.70	120.76	114.23	116.55	115.04	113.21	111.12	109.69	106.44	102.87	108.21	106.63	105.55	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e Interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2023 Janar January	2023 Shkurt February	2023 Mars March	2023 Prill April	2023 Maj May	2023 Qershor June	2023 Korrik July	2023 Gusht August	2023 Shtator September	2023 Tetor October	In percent
Norma e Interesit të depozitave për Individë											Interest rates on households deposits
Deri në 1 vit	1.06	1.08	1.02	0.98	1.07	0.97	1.01	1.18	1.21	1.17	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	1.72	1.93	1.53	1.63	1.81	1.72	1.72	2.13	2.31	2.36	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	2.89	2.83	2.84	2.80	2.92	2.95	2.92	3.06	3.03	3.07	Over 2 years
Norma e interesit të depozitave për korporatat jo-financiare											Interest rates on nonfinancial corporations deposits
Deri në 1 vit	2.15	1.34	1.76	1.47	2.99	1.17	2.56	2.53	2.47	2.46	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	4.97	3.61	2.47	2.41	2.48	2.61	2.80	2.96	2.64	2.78	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	3.32	3.19	2.35	2.24	2.23	3.29	2.09	3.99	3.58	4.27	Over 2 years
Normat e Interesit të kredive per Individet											Interest rates on household loans
Kredi për banesa	4.41	4.31	4.42	4.23	3.96	4.30	4.04	3.89	4.13	4.05	Lending for house purchase
Kredi konsumatore	8.89	9.91	9.60	9.57	9.54	8.99	9.42	9.34	9.27	9.33	Consumer credit
Kredi për qëllime të tjera	12.66	15.26	9.15	9.29	10.43	10.13	9.45	12.23	12.64	12.90	Credit for other purposes
Normat e Interesit të kredive per korporatat jofinanciare											Interest rates on nonfinancial corporations loans
Kredi deri në 140 milion lekë	7.89	7.61	7.68	6.76	7.00	7.26	6.63	6.68	6.59	6.54	Loans up to to an amount of 140 millions of lek
Kredi mbi 140 milionë lekë	6.09	7.00	7.54	5.83	6.48	6.26	6.30	6.00	5.51	5.81	Loans over an amount of 140 millions of lek
Norma e letrave me vlerë											Securities rates
Bono thesari 1/											Treasury bills 1/
3-M	3.03	2.76	2.80	3.05	3.00	-	-	-	3.00	-	3-M
6-M	4.57	4.37	3.26	3.29	-	3.18	-	-	-	1.50	6-M
12-M	5.19	4.46	3.94	3.87	3.65	3.27	3.12	3.15	3.15	3.11	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2023

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2023

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	50,274	97,112	156,107	207,513	258,192	319,993	372,172	425,547	477,319	530,831	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	1,297	6,854	7,309	8,357	9,390	19,583	19,749	20,210	20,379	20,613	Grands
II.	Të ardhura tatimore	47,343	86,850	143,527	191,290	239,176	288,918	339,197	390,752	440,434	492,072	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	33,341	60,922	104,674	135,967	169,169	204,373	239,056	276,839	312,452	346,781	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	16,977	30,519	45,902	60,497	76,829	93,009	109,394	126,206	143,569	161,247	V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	2,397	4,875	21,608	25,831	29,262	33,827	36,973	40,903	44,934	47,875	Profit Tax
3	Akcizat	4,102	8,226	12,056	16,043	21,134	26,383	31,881	38,164	43,114	48,092	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	5,258	9,063	13,236	18,112	22,800	27,792	33,091	39,335	43,819	48,392	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	4,023	6,983	9,895	12,824	15,658	19,121	22,642	26,344	30,315	33,650	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	584	1,256	1,977	2,660	3,487	4,241	5,075	5,888	6,700	7,524	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	1,407	2,915	5,070	9,147	12,439	15,362	17,203	19,049	21,354	24,625	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	284	533	1,029	2,208	2,729	3,314	3,700	4,185	4,629	5,156	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	0	5	12	20	27	33	36	42	46	51	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,123	2,377	4,030	6,919	9,684	12,015	13,466	14,822	16,678	19,418	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	12,596	23,013	33,783	46,176	57,569	69,183	82,938	94,864	106,628	120,667	Social Ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	10,820	19,834	29,176	39,764	49,639	59,718	71,503	81,783	91,995	104,034	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,712	3,046	4,402	6,091	7,559	9,028	10,923	12,518	14,029	15,969	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	64	133	205	321	370	436	513	562	604	664	Compensation income in the value of owners
III.	Të ardhura Jotatimore	1,634	3,409	5,271	7,865	9,625	11,492	13,226	14,585	16,506	18,146	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	954	2,049	3,247	5,211	6,252	7,358	8,347	8,998	9,912	10,708	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	214	404	642	808	1,072	1,299	1,664	1,933	2,363	2,681	Utility fees
4	Të tjera	465	955	1,364	1,828	2,283	1,379	3,186	3,624	4,200	4,727	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	35,352	73,466	125,232	172,957	222,195	273,836	326,913	377,885	425,938	482,947	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	34,324	71,699	112,498	154,848	198,029	242,880	289,904	335,698	379,459	428,132	Current Expenditures
I.1	Personeli	7,247	14,580	21,963	29,511	37,289	46,284	55,474	63,984	72,410	81,060	Personnel expenditures
1	Paga	6,218	12,504	18,832	25,305	31,958	39,664	47,368	54,550	61,742	69,161	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	1,020	2,053	3,087	4,134	5,230	6,440	7,670	8,841	9,991	11,152	Social insurance contributions
3	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	9	23	44	72	102	180	436	593	678	748	Higher education from its own income
I.2	Interesat	5,426	7,657	12,051	14,768	16,613	20,705	26,541	30,107	34,757	40,500	Interest
1	Të Brendshme	4,314	5,773	9,120	11,156	11,709	12,522	17,336	20,161	23,510	26,292	Domestic
2	Të Huaja	1,112	1,884	2,932	3,612	4,903	8,183	9,205	9,946	11,248	14,208	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,635	5,742	10,294	14,785	22,000	27,260	32,652	37,861	42,449	48,089	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	79	266	378	499	600	701	843	940	1,126	1,297	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	15,616	32,037	48,598	68,462	86,118	104,822	123,120	143,236	161,367	181,112	Social Insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	12,576	24,399	36,771	52,114	65,338	79,182	93,029	108,432	122,309	136,301	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	3,032	7,202	11,292	15,815	20,247	24,748	29,073	33,786	38,038	43,594	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	8	436	535	532	534	892	1,018	1,019	1,019	1,217	Owners' Compensation Fund
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	2,694	7,170	12,528	17,695	23,776	28,957	34,651	40,357	45,721	51,894	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,627	4,248	6,685	9,129	11,632	14,151	16,623	19,213	21,630	24,182	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	63	108	188	255	327	404	475	542	636	709	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,264	3,379	5,454	7,554	9,614	11,602	13,703	15,729	17,752	19,810	Economic Aid
3	Bonusi i lindjeve	300	500	700	900	1,200	1,400	1,700	2,100	2,400	2,700	Birth bonus
I.8	Transferime Kapitale	0	0	0	0	0	0	121	121	121	121	Capital transfers
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	1,028	1,767	12,734	17,989	24,045	30,835	36,888	42,065	46,358	54,693	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	0	286	9,564	13,065	17,442	22,400	26,558	29,707	33,025	39,760	Domestically financing
2	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	0	17	46	203	267	331	345	364	404	433	From higher education system's own revenues
3	Financimi Huaj	1,028	1,413	2,248	2,954	3,662	4,630	5,694	7,429	7,918	9,140	Foreign financed
IV	Fondi i rindertimit	0	50	876	1,767	2,674	3,475	4,291	4,566	5,012	5,359	Reconstruction fund
V.	DEFICITI	-14,922	23,646	30,876	34,555	35,997	46,157	45,259	47,662	51,381	47,884	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-14,922	-23,646	-30,876	-34,555	-35,997	-46,157	-45,259	-47,662	-51,381	-47,884	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-14,096	-20,819	-24,359	-21,931	-21,155	-91,831	-88,290	-89,013	-90,594	-82,348	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	5	9	17	20	23	26	28	30	40	44	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	10,909	5,506	12,662	20,312	27,542	33,632	21,305	21,566	22,122	11,862	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-25,010	-26,333	-37,038	-42,263	-48,720	-125,489	-109,623	-110,609	-112,756	-94,253	Others
V.3	I huaj	-826	-2,828	-6,517	-12,624	-14,842	45,674	43,031	41,350	39,213	34,464	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	962	1,961	2,097	2,349	2,441	2,141	2,805	4,232	4,294	5,182	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-189	-980	-709	-1,252	-896	204	494	383	663.02	816.43	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,599	-3,808	-7,905	-13,720	-16,387	-19,444	-23,040	-26,038	-28,516	-34,308	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Budgetary Support

Burlimi : Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source : Ministry of Finance and Economy

Tabela e investimeve 2023

Table of investments 2023

Të dhëna progresive (Progressive Data)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	
	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	
Financim i brendshëm	-14,096	-20,819	-24,359	-21,931	-21,155	-91,831	-88,290	-89,013	-90,594	-82,348	Domestic financing
Në %	94.5	88.0	78.9	63.5	58.8	199.0	195.1	186.8	176.3	172.0	In %
Financim i huaj	-826	-2,828	-6,517	-12,624	-14,842	45,674	43,031	41,350	39,213	34,464	Foreign financing
Në %	5.5	12.0	21.1	36.5	41.2	-99.0	-95.1	-86.8	-76.3	-72.0	In %
Totali	-14,922	-23,646	-30,876	-34,555	-35,997	-46,157	-45,259	-47,663	-51,381	-47,884	Total
Në %	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë**Source:** Ministry of Finance and Economy

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2023
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2023

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	
Taksë doganore	584	1,256	1,977	2,660	3,487	4,241	5,075	5,888	6,700	7,524	Customs Duties
TVSH	9,878	20,632	32,958	44,710	58,181	70,715	82,918	95,306	107,725	120,850	V.A.T
Akcizë	4,102	8,226	12,056	16,043	21,134	26,383	31,881	38,164	43,114	48,092	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	235	455	827	1,055	1,316	1,528	1,822	2,030	2,276	2,515	Others (Mineral Rent)
TOTALI	14,799	30,569	47,818	64,469	84,118	102,867	121,696	141,388	159,815	178,980	Total
TË ARDHURAT TATIMORE 2023 (TAX REVENUE)											
TVSH	7,099	9,887	12,944	15,787	18,647	22,294	26,476	30,900	35,844	40,397	V.A.T
